



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM

Nr. 244, datë 30.06.2022

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Përrjashtim i gjyqtarit Aurel Arapi.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Elsa Ulliri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; I pandehur: {...}; Akuza: Neni 283/2, 284/2 dhe 137/2 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 130/a/4 e 321/1 i Kodit Penal.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Etleva Gjamo, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Padi të: {...}; E paditur: {...}; Objekti: Sigurim padie ndaj shkresës me nr.966 prot, datë 22.06.2017 {...}, për detyrimin e vendosur në shumën 4.061.844.67 lekë ndaj Drejtorisë së Rajonit Jugor deri sa të merret vendimi i formës së prerë për gjykimin e çështjes në themel.

2. Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Etleva Gjamo dhe Ligoraq Toshi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Padi të: {...}, {...}; E paditur {...}, {...}, pranë Ministrisë së Turizmit, Erdion Muho; Objekti: Detyrimin e palës së paditur {...} të lidhë kontratën e e shitjes së truallit dhe kontratën e shitblerjes me paditësit truall i dhënë me vendimin nr.1, datë 28.08.1999 të Këshillit Bashkiak. Detyrimin e palëve të paditura që të anulojnë pjesërisht veprimin administrativ kontrata me nr.447 prot, datë 22.04.2022 të firmosur nga {...} prot, datë 04.05.2022 të firmosur nga {...} me subjektin përfitues {...}.

3. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Padi të: {...}; I paditur: {...}, {...}, {...}; Personi i tretë: {...}; Objekti: Marrjen e masës së sigurimit të padisë, detyrimin e të paditurve të pezullojnë dhënie me qera të parcelës “stacion plazhi” {...} me sipërfaqe prej 627 m2 të ndodhur në {...}, plazhi Ksamil për ushtrim aktiviteti për sezonin veror të vitit 2022 në favor të subjektit Foti Doda deri në zgjidhjen e çështjes në themel. Detyrimin e të paditurve të lejojnë vazhdimin e ushtrimit të aktivitetit për sezonin veror në parcelën 627 m2 në Bashkinë Sarandë, plazhi Ksamil subjektit {...} sipas kualifikimit paraprak datë 11.03.2022 të bërë nga {...} dhe miratimit nga {...}.

4. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Padi të: {...} me administrator Gentiall Llogo; I paditur: {...}; Objekti: Kthim shume për llogari të Ujësjetës Kanalizime në vlerën 719.280 (shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë, lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për periudhën 2016-2018 për prokurimin me objekt “Shërbim të sigurimit dhe ruajtjes fizike” nga Operatori ekonomik “{...}”

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Markelian Koça, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me Padi të: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Përmbushje detyrimi kontraktor (Kthim Aktesh);

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Markelian Koça, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Pavlefshmëri titulli ekzekutiv.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Vrasje.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Genti Dokollari dhe Adelajda Gjuzi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...} etj.; Akuza: Pastrimi i produkteve të veprës penale.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Adelajda Gjuzi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...} etj.; Akuza: Ndhimë për kalimin të paligjshëm të kufirit.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia dhe Adelajda Gjuzi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Vrasje në rrethana cilësuese etj.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia (relator), Genti Dokollari dhe Adelajda Gjuzi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Vjedhje me armë.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR